

## **Izet MIFTARI**

### **EFEKTET POLITIKE NË ISH-JUGOSLLAVI TË MARSHIT DHE TË GREVËS SË MINATORËVE TË TREPÇËS NË STANTËRG, MË 1988 DHE 1989**

#### **Abstrakt:**

*Pas Demonstratave të vitit 1981 e veçanërisht pas ardhjes së Sllobodan Millosheviqit në krye të Serbisë, më 1986, pozita e shqiptarëve të Kosovës u keqësua edhe më shumë. Realisht, ngritja me e madhe e Millosheviqi, filloi pas vizitës që ai i bëri Kosovës, në prill 1987. Që nga ajo kohë, gjendja në Kosovë filloi të rëndohet shumë, sepse tani filloi edhe hapur të diskutohet ndryshimi i Kushtetutës së vitit 1974, çka nënkuptonte se shqiptarëve të Kosovës do t'ju hekën edhe ato të drejta të kufizuara që i kishin, sipas Kushtetutës në fjalë. Prandaj, te shqiptarët filloi haptas të kundërshtohet kjo nismë. Këtë e kundërshtuan edhe minatorët e Trepçës në Stantërg, të cilët filluan me marshin në këmbë nga Mitrovica në Prishtinë, më 17 nëntor 1988. Ky marsh do të rezultojë pastaj me grevën 8-ditore të 1 300 minatorëve, të cilët u mbyllën në horizontin e tetë të minierës. Kjo grevë filloi më 20 dhe mbaroi më 28 shkurt 1989. Efektet politike të këtyre dy ngjarjeve në ish-Jugosllavi, e sidomos efekti i grevës ka qenë i madh. Solidarizimi me grevistët në tërë Kosovën ishte shumë i madh. Me grevistët u solidarizua edhe Sllovenia. Prandaj, në përkrahje të minatorëve grevistë ishte mbajtur një tubim në Lubljanë. Në këtë situatë, grevistët i vizituan dhjetëra politikanë me ndikim të kohës duke përfshirë: Stipe Shuvarin (anëtar i Kryesisë së ish-Jugosllavisë, që përfaqësonte Kroacinë) dhe Remzi Kolgecin (kryetar i Kryesisë së*

*Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës 1988-1990). Përmes këtij punimi, do të bëjmë përpjekje që të ndriçojmë saktë ndikimin që, marshi dhe greva e minorëve, pati në proceset politike në Kosovë më 1989-1999 dhe shpërbërjes së ish-Jugosllavisë titiste.*

**Fjalët kyçe:** *Kosova, greva e minorëve, Trepça, Stantërgu, ish-Jugosllavia, vitet 1988-1989.*

Në përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në fund të vitit 1944, Kosova dhe pjesët e tjera shqiptare u ripushtuan përsëri nga Jugosllavia komuniste-socialiste, e udhëhequr nga Josip Broz Tito. Realisht, me këtë pushtim, shqiptarët nuk ishin pajtuar asnjëherë duke vazhduar rezistencën në forma të ndryshme. Megjithatë, pas vitit 1966, veçanërisht pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 1974, pozita e shqiptarëve në Kosovë paksa ishte përmirësuar. Mirëpo, kjo nuk nënkuptonte se shqiptarët pajtoheshin me gjendjen e re, të krijuar pas hyrjes në fuqi të kushtetutës në fjalë, ngase Kosova nuk ishte avancuar në republikë, por trajtohej si autonomi në kuadër të Serbisë dhe ish-Jugosllavisë. Po ashtu, pakënaqësinë e shqiptarëve në Kosovë e rëndonte edhe më shumë fakti se, Kosova ishte vendi më i pazhvilluar në ish-Jugosllavinë titiste. Prandaj, në vitin 1981, kishin shpërthyer demonstrata e shqiptarëve në Kosovë, në krye të të cilave ishin studentët e Universitetit të Prishtinës.

Në këto demonstrata, ndër kërkesa kryesore kishte qenë që Kosova të bëhej republikë në kuadër të Federatës Jugosllave. Mirëpo, Demonstratat e vitit 1981 u shtypën me dhunë dhe kështu, nga kjo kohë, pozita e shqiptarëve u keqësua shumë. Filluan burgosjet, maltretimet, diferencimet dhe masat e tjera kundër shqiptarëve. Në këtë kohë filloi edhe një lëvizje e gjerë masive serbe, sidomos e atyre që jetonin në Kosovë, kinse për të përmirësuar të drejtat e serbëve në Kosovë, që gjoja për shkeleshin nga shqiptarët. Këto lëvizje apo këto tubime u intensifikuan shumë pas ardhjes së diktatorit Sllobodan Millosheviq në krye të Serbisë. Ai haptas kishte shprehur qëndrimin

antishqiptar dhe kishte filluar me veprime konkrete, me qëllim që të abrogonte Autonominë e Kosovës. Në rrethana të tilla filluan lëvizjet masive edhe te shqiptarët duke kundërshtuar tubimet nacionaliste serbe dhe kërkesën e tyre për të hequr Autonominë e Kosovës, të vitit 1974. Prandaj, një nga lëvizjet më masive për të kundërshtuar suprimimin e autonomisë dhe për të përmirësuar gjendjen e shqiptarëve, ishte marshi dhe greva e minatorëve të Trepçës në Stantërg të Mitrovicës, që ndodhën gjatë viteve 1988 dhe 1989. Me kërkesat e minatorëve u solidarizuan thuajse tërë shqiptarët e Kosovës, veçanërisht rinia dhe studentët.

### **Marshi i minatorëve më 17-21 nëntor 1988**

Edhe para Demonstratave të vitit 1981 ekzistonte një propagandë antishqiptare nga qarqe të caktuara serbe në Beograd. Ajo u intensifikua me ritme shumë të larta pas demonstratave në fjalë, e veçanërisht pas ardhjes në krye të Serbisë të diktatorit Slobodan Millosheviqit, më 1986. Bazuar nga të dhënat e kohës, sidomos nga shtypi e mediat, si dhe nga protagonistët dhe përjetuesit e këtyre viteve, kuptojmë se në periudhën 1986-1990, janë mbajtur qindra tubime nëpër qytete të ndryshme të Serbisë, në të cilat kanë marrë pjesë, krahas serbëve të Kosovës edhe shumë tjerë të Serbisë. Këto tubime kanë qenë kinse për të mbrojtur serbët e Kosovës nga keqtrajtimet që ua paskan bërë e po ua bëjnë shqiptarët. Nëpër ato tubime, krahas marshit protestues, shihet se ata mbanin edhe mbishkrime raciste antishqiptare dhe kundër Kosovës.<sup>1</sup> Në krye të krejt këtyre tubimeve, që në fakt kishin prapavijë shoviniste, me qëllim që të krijohet Serbia e Madhe, qëndronte Millosheviqi. Ky, nëpërmjet mitingjeve kinse të solidaritetit me serbë, programeve televizive dhe të mediave, i cili e ktheu në mision qëllimin e tij, kishte deklaruar: “Serbët humbën në paqe atë që e fituan në luftë”.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Вуксан Церовић, *Косово - Контрареволуција која тече*, Београд, 1989, 430-439.

<sup>2</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar IV*, Tiranë, 2008, 371.

Vizita e Millosheviqit në Fushë-Kosovë, më 26 prill të vitit 1987, nga shumë studiues, analistë e publicistë, krahas Demonstratave të vitit 1981 konsiderohet si fillimi i shkatërrimit të ish-Jugosllavisë titiste dhe nisjes së luftërave tragjike në këtë vend, që u zhvilluan në vitet e '90-ta të shekullit të kaluar. Agjenturat dhe shërbimet serbe kurdisën dhe montuan me një mjeshtri të sofistikuar vizitën e Millosheviqit në Kosovë. Kështu, gjatë tubimit aty, në prill 1987, u dëgjuan zëra që tingëllonin e shkaktonin emocion, si thirrjet “po na rrahin”, “po na rrahin”, që nënkuptonte se kinse serbët po keqtrajtoheshin nga shqiptarët. Pas kësaj, si një shfrytëzues perfid i situatës, Millosheviqi u elektrizua dhe masës së mbledhur u tha fjalët: “Askush nuk duhet të guxoj t’iu rrahë”. As një fije floku nuk guxojnë t’ju prekin”.<sup>3</sup>

Media kryesore e ish-Jugosllavisë, Radiotelevizioni i Beogradit, ishte kthyer në një mjet të fuqishëm për të promovuar e propaganduar këtë personalitet, që gradualisht u shndërrua në kinse shpëtimtarin e serbëve dhe të Serbisë. Andaj, fjalët e Millosheviqit në Fushë-Kosovë (me gjasë jo rastësisht ishin tubuar aty, sepse, në mitin serb, Fusha e Kosovës është vendi i betejës së nderit, ku qenka mbrojtur Kosova nga serbët kundër pushtuesve osmanë (turq), më 1389), transmetoheshin thuajse çdo ditë, me qëllim që të forcohej pozicioni i tij. Në këtë rrjedhë mbaheshin shumë tubime në Serbi, veçanërisht në Beograd, ku merrnin pjesë edhe serbët e Kosovës për të protestuar për gjendjen e rënduar që pandehej se e kishin ata, gjoja si pasojë e keqtrajttimeve nga shqiptarët dhe e të drejtave që kishin sipas Kushtetutës së vitit 1974 dhe që e njëjta në anën tjetër po ua shkelte të drejtat serbëve.<sup>4</sup> Andaj, filloi të diskutohej haptas ndryshimi i Kushtetutës së '74-ës dhe abrogimi i saj, me qëllim që në Kosovë përsëri të vendosej regjimi pushtues serb. Në rrethana të tilla, ishte e kuptueshme se ndaj veprimeve të tilla të Serbisë, do të ketë kundërveprime të fuqishme nga ana e shqiptarëve.

<sup>3</sup> Noel Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtë*, Prishtinë, 2011, 427.

<sup>4</sup> Вуксан Церковић, *Косово - Контрареволуција...*, 430-439.

Kështu, reagimet e para masovike të shqiptarëve kundër keqtrajtimit nga politika diskriminuese antishqiptare e Serbisë, mitingjeve kundër Kosovës sidomos kundër shqiptarëve dhe planit për suprimimin e Autonomisë së Kosovës u mbajtën nga 17 deri më 21 nëntor 1988. Të parët që e filluan kundërshtimin në formë të protestës ishin punëtorët shqiptarë nga Stantërgu dhe Kombinati “Trepça” në Mitrovicë. Andaj, më 17 nëntor 1988, në mëngjes, minatorët e ndërrimit të parë dhe të tretë vendosën që revoltën e tyre kundër gjendjes së rëndë të shqiptarëve në Kosovë ta shprehin me organizimin e marshit (ecjes në këmbë) protestues nga Stantërgu deri në Prishtinë.

Minatorët të cilëve gjatë rrugës iu bashkuan edhe shumë punëtorë të tjerë, marshuan këmbë në magjistralen Mitrovicë (Stantërg) - Vushtrri - Prishtinë (52 kilometra rrugë).<sup>5</sup> Kur arritën në Vushtrri, minatorëve iu bashkëngjitën edhe shumë punëtorë dhe qytetarë të kësaj komune. Me marshimin e minatorëve, me kërkesat e tyre dhe formën e protestës u solidarizuan pothuajse tërë ndërmarrjet, organizatat, fabrikat e Kosovës. Me kërkesat e minatorëve duke marshuar në këmbë nga Mitrovica në Prishtinë, u solidarizuan po ashtu punëtorët e ish-fabrikave: Ekstra, Polet, Lllamarina etj., në Vushtrri.<sup>6</sup> Gjatë marshimeve dhe tubimeve protestuese në Prishtinë, ndër parullat kryesore kanë qenë: “Rroftë Kushtetuta e vitit 1974”, “Të ruhen parimet e Kushtetutës së vitit 1974”, “Ndërrime po, por vetëm ato që çojnë në demokratizim”, “Poshtë politika serbomadhe”. etj.<sup>7</sup> Marshimet protestuese zgjatën 5 ditë dhe kërkesat e drejta të protestuesve shqiptarë jo vetëm që nuk u përfillën, por u vlerësuan si të papranueshme dhe armiqësore. Kurse kërkesat shoviniste të serbëve dhe malazezëve të Kosovës nga udhëheqësit politikë të Serbisë, konsideroheshin të “drejta” dhe të “qëlluara”.

<sup>5</sup> Izet S. Miftari, *Viciana - Vushtrria I*, Prishtinë, 2021, 261.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Aziz Abrashi - Burhan Kavaja, *Epopeja e minatorëve*, Prishtinë, 1996, 25.

Arsyen e fillimit të marshit të minatorëve më 17 nëntorit 1988, e sqaron shumë mirë Mikel Ndreca, i cili ka shkruar: *Nxjerrjes së Kushtetutës të RS-së së Serbisë i paraprinë shumë ngjarje të përgjakshme të përgatitura dhe të zbatuara në regjinë e udhëheqjes shoviniste serbe, në të cilat protagonistë kryesorë ishin shqiptarët. Pas shtatë vitesh (nga viti 1981, IM) të propagandës së zezë antishqiptare dhe të presionit brutal politik, psikologjik dhe fizik, shqiptarët vendosën të flasin, sepse me gjithë presionet mbi ta, ata akuzoheshin edhe për heshtje. “Pse nuk flasin shqiptarët?” - përsëritej përditë. Pikërisht, më 17 nëntor 1988, të parët reagues minatorët shqiptarë të Stantërgut. Atë ditë, ata u nisën këmbë nga Mitrovica në Prishtinë për të reaguar në mënyrë demokratike për shkak se për shtatë vjet me radhë ishin të ekspozuar përball përbuzjeve, ofendimeve, fyerjeve, presioneve johumane dhe terrorit politik e shtetëror. Ishin disa mijëra. Gjurmëve të tyre u nis e tërë klasa punëtore, qytetarët dhe rinia shqiptare nga të gjitha qendrat dhe viset e Kosovës. Protestat e tyre të qeta, të padhunshme dhe demokratike nuk u jepnin shkas me asgjë organeve shtetërore dhe politike që të ndërmarrin masa represive ndaj tyre. Ata kërkonin liri, drejtësi dhe barazi, kërkonin ndërprerjen e masave jonjerëzore, jociwilizuese, anakronike politike dhe masave tjera represive. Kërkonin që të ndërpriten akuzat e paargumentuara me asnjë fakt dhe sulmet mbi çdo gjë shqiptare dhe e lidhur me shqiptarët.<sup>8</sup>*

Mirëpo, marshi i minatorëve dhe i gjithë qytetarëve të Kosovës, më 17 nëntor 1988, nuk arriti të ndalonte propagandën antishqiptare dhe nismën për amendamentim (ndërrimet kushtetuese) të Kushtetutës së vitit 1974, që nënkuptonte se Kosovës do t'i hiqej autonomia dhe do të pushtohej në mënyrë klasike nga Serbia. Nga ana tjetër, pikërisht në ditën kur ishte duke u mbajtur marshi protestues kundër diskriminimit që po u bëhej shqiptarëve, me organizimin e Millosheviqit, që tashmë ishte fuqia kryesore në Serbi, më 20 nëntor

---

<sup>8</sup> Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999)*, Prishtinë, 2001, 250.

1988, në Beograd u mbajt një miting i madh, në të cilin morën pjesë mbi 350 mijë veta. Masës së tubuar aty, u foli Millosheviq, duke mbajtur fjalim të zjarrtë nationalist. Ndër të tjera, ai kishte thënë: “Çdo komb e ka një dashuri që ia ngroh zemrën përgjithmonë. Për Serbinë, ajo dashuri është Kosova”.<sup>9</sup> Vlen të thuhet se, para këtij mitingu të madh serb, që ishte koduar si “Mitingu mbi mitingjet”, Kisha Ortodokse Serbe kishte organizuar një ritual simbolik që më vonë doli të ishte paralajmërim i kobshëm. Ajo organizoi bartjen rituale të kinse eshtrave të car Llazarit nëpër të gjitha trevat ku jetonin serbët. Dy vjet më vonë, më 1991, nëpër ato vija, filluan luftërat për kufijtë e “Serbisë së Madhe”.<sup>10</sup>

Kundërshtimet e shumta në forma të ndryshme për të mos u lejuar ndërrimet kushtetuese të vitit 1974, sollën një situatë edhe më të rënduar në Kosovë. Kështu, fundi i vitit 1988 dhe viti 1989, ishin periudhë me një sërë ndryshimesh dhe ngjarjesh të mëdha që ndodhën në Kosovë. Duhet thënë se, para se të ndërrohej me dhunë Kushtetuta e vitit 1974, në nëntor të vitit 1987, ishte ndërruar edhe simboli kombëtar i shqiptarëve që përdorej në atë kohë. Kështu, në vend të flamurit zyrtar që ishte, vendoset që ylli pesëcepësh i vogël mbi krerët e shqiptonjës<sup>11</sup>, të largohet nga aty dhe të vendoset në anën e majtë të flamurit. Ylli dhe shqiptonja kishin pak a shumë madhësi të njëjtë. Si flamur i tillë, sipas kujtimeve të Azem Vllasit, për herë të parë u shfaq publikisht me rastin e festave të nëntorit, Ditës së Republikës së ish-Jugosllavisë, më 29 nëntor 1987.<sup>12</sup> Mirëpo, pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe rënies së sistemit komunist në Shqipëri, edhe flamuri

<sup>9</sup> Noel Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtë...*, 429.

<sup>10</sup> Azem Vllasi, *Populli që shkroi historinë - vitet e zgjimit*, Prishtinë, 2023, 96.

<sup>11</sup> Ylli pesëcepësh mbi shqiptonjë ishte vendosur nga Partia Komuniste e Shqipërisë dhe si flamur shtetëror i Shqipërisë, i tillë ishte nga viti 1944 e deri me rënien e sistemit komunist në Shqipëri, më 1990. Kështu, që nga viti 1990, flamuri i shtetit shqiptar, që në fakt është simbol kombëtar i gjithë shqiptarëve, kudo që jetojnë, ka vetëm shqiptonjën dykrenore me ngjyrë të zezë dhe sfondin e kuq.

<sup>12</sup> Azem Vllasi, *Kosova - fillimi që nuk harrohet*, Prishtinë, 2017, 464.

në fjalë i Kosovës, edhe ai i kohës së komunizmit në Shqipëri, u ndryshuan ngase ju hoq ylli pesëcepësh.

### **Greva e minatorëve më 20-28 shkurt 1989**

Viti 1989 do të jetë një nga vitet më dramatike në Kosovë, sepse pati zhvillime të mëdha si në Kosovë, ashtu edhe në mbarë ish-Jugosllavinë dhe vendet e ish-blokut socialist. Kështu, ndër reagimet më të fuqishme kundër suprimimit të Autonomisë së Kosovës dhe padrejtësive që u bëheshin shqiptarëve, ishte greva e xehetarëve të Stantërgut të Kombinatis “Trepça” në Mitrovicë. Greva filloi më 20 dhe zgjati deri më 28 shkurt të vitit 1989.<sup>13</sup> Grevën e filluan 441 minatorë të ndërrimit të parë, 315 të ndërrimit të dytë dhe 140 minatorë të ndërrimit të tretë. Informatat e para për grevën e minatorëve i kishte dhënë drejtori teknik i minierës së “Trepçës” së Stantërgut, inxhinieri Ibush Jonuzi.<sup>14</sup> Minatorët qëndruan në horizontin e tetë të minierës (800 metra thellësi) 8 ditë e katër orë (196 orë). Me fillimin e grevës, minatorët i kishin shpallur kërkesat e tyre zyrtare, të përfshira në 11 pika, por që pika e njëmbëdhjetë (11), në të cilën duhej të përfshihej kërkesa që Kosova të bëhej republikë, për shkak të rrethanave specifike që mbizotëronin, nuk ishte publikuar.<sup>15</sup> Kërkesat e minatorëve ishin:

1. Granaci për respektimin e parimeve të Kushtetutës së vitit 1974.
2. Të publikohet lista e organizatorëve të protestave të nëntorit (1988), sepse të gjithë minatorët ishin organizatorë të atyre marsheve protestuese, ngase nuk kishte në mesin e tyre organizatorë të veçantë.

---

<sup>13</sup> Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Kosova - vështrim monografik*, Prishtinë, 2011, 244.

<sup>14</sup> Aziz Abrashi - Burhan Kavaja, *Epopeja e minatorëve...*, 33.

<sup>15</sup> Muhamet Pirraku, *Lëvizja gjithëpopullore shqiptare për faljen e gjaqeve 1990-1992*, Prishtinë, 1998, 14; Aziz Abrashi - Burhan Kavaja, *Epopeja e minatorëve...*, 39.

3. Të thirrën në përgjegjësi ata, të cilët kishin hartuar projektligjin për pensionim të parakohshëm të mësimdhënësve në Kosovë.
4. Rrahman Morina<sup>16</sup> të shkarkohet nga pozita e kryetarit të kryesisë të Komitetit Krahinor të Lidhje së Komunistëve (LK) të Kosovës, ngase nuk e kishte mbajtur fjalën që ua kishte dhënë minatorëve. Gjithashtu të japin dorëheqje edhe Ali Shukriu<sup>17</sup> dhe Hysamedin Azemi.<sup>18</sup>

<sup>16</sup> Rrahman Morina ishte politikan në Kosovë i viteve të '80-ta të shekullit të kaluar. U lind më 1943 në Loxhë të Pejës. Punoi një kohë në polici. Pas Demonstrative të vitit 1981, u emërua sekretar krahinor i Punëve të Brendshme, post të cilin e mbajti deri në vitin 1988. Me ndihmën e qarqeve serbe, më 1988 u zgjodh kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste. Me ardhjen e Sllobodan Millosheviqit në krye të Serbisë, u bë i njohur si bashkëpunëtor i tij duke u përfshirë në grupin e funksionarëve politikë të Kosovës, që i shërbyen politikës antishqiptare që udhëhiqnin institucionet partiake e shtetërore të Serbisë në këtë kohë. Më 1989, pas grevës së minatorëve dha dorëheqje, por pas ndërprerjes së grevës, u rikthye përsëri në postin që kishte. Vdiq më 1990, në sallën e Kuvendit të Kosovës në Prishtinë, derisa po mbahej Kuvendi Themelues i Partisë Socialiste të Serbisë, dega në Kosovë. U varros në “Varrezat e martirëve” në Beograd (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës II, L-ZH*, Prishtinë, 2018, 1131).

<sup>17</sup> Ali Shukriu u lind më 1919 në Mitrovicë. Që në vitin 1939 iu bashkëngjit lëvizjes komuniste jugosllave. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u angazhua në organizmin dhe në përhapjen e ideve komuniste dhe të Luftës Antifashiste. Përkundër faktit se ishte caktuar delegat i Konferencës së Bujanit, ai nuk kishte marrë pjesë në këtë konferencë. Pas LDB-së ishte prokuror politik në Prishtinë, ku u dallua për dënime të rënda ndaj kundërshtarëve politikë. Pasi përfundoi shkollën politike “Gjuro Gjakoviq”, më vonë ushtroi funksione të larta në pushtetin krahinor dhe qendror të ish-Jugosllavisë. Ishte nënkryetar dhe pastaj kryetar i Këshillit Ekzekutiv (Qeverisë në atë kohë) të Kosovës. Pas vitit 1981 u dallua për diskursin e ashpër antishqiptar dhe në mbështetje të nacionalizmit serb. Vdiq më 2005 në Beograd, ku edhe u varros. (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës II, L-ZH*, Prishtinë, 2018, 1633).

<sup>18</sup> Hysamedin Azemi u lind në vitin 1939 në Mitrovicë. Studioi shkencat politike në Universitetin e Beogradit. Në vitet 1972-1978 ka qenë anëtar i Komitetit Qendror të Serbisë për dy mandate. Gjatë viteve 1986-1988 ka qenë kryetar i Lidhjes së Sindikatave të Kosovës. Në vitin 1988, ai bëhet Sekretar i Komitetit Komunal të

5. Të ndërpritet politika e gabuar ndaj popullit shqiptar.
6. Menjëherë të vijnë Stipe Shuvari,<sup>19</sup> Sillobodan Millosheviqi e Ali Shukriu. Minatorët kërkojnë që atyre t'u flasin drejtpërdrejt për politikën diskriminuese ndaj shqiptarëve, të cilës ata po i kontribuojnë.
7. Nuk ka organizatorë të veçantë të grevës, por të gjithë jemi organizatorë.
8. Personat e panjohur nuk mund të hyjnë në zgafelle të minierës.
9. Përfaqësuesit e krahinave dhe të republikave të njoftohen për gjendjen në Kosovë.
10. Kërkojmë ndërkombëtarizmin e çështjes së Kosovës dhe shqyrtimin e statusit të Kosovës në Kombet e Bashkuara.<sup>20</sup>

---

Prishtinës. Ka qenë kryetar i Odës Ekonomike për dy mandate: në vitet 1984-1986, si dhe 1989 deri 1991.

<sup>19</sup> Stipe Šušvar u lind 17 shkurt 1936 në Zagvozd (Kroaci) dhe vdiq në Zagreb më 29 qershor 2004. Ishte politikan dhe sociolog kroat, i cili konsiderohej të kishte qenë një nga politikanët komunistë më me ndikim në Lidhjen e Komunistëve të Kroacisë në vitet e '80-ta të shekullit të kaluar. Ai hyri në politikë më 1972. Dy vjet më vonë u bë ministër i Arsimit i Republikës Socialiste të Kroacisë, që ishte pjesë e ish-Jugosllavisë titiste. Në vitin 1980 ishte anëtar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Kroate, më pas anëtar dhe kryetar i Kryesisë së KQ të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Në vitin 1989, Parlamenti kroat emëroi Shuvarin për të përfaqësuar Kroacinë në Presidencën e Jugosllavisë, që përbëhej nga tetë anëtarë, por u shkarkua një vit më vonë, kur pas zgjedhjeve të para shumëpartiake në Kroaci, ajo tashmë dominohej nga Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ) i Franjo Tugjmanit. Ai kishte vizituar minatorët grevistë të "Trepçës" në shkurt 1989, por që nuk u kishte premtuar asgjë dhe konsiderohet se nuk ishte pajtuar me kërkesat e grevistëve. Pas rënies së komunizmit dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, Šušvar themeloi revistën "Hrvatska ljevica" (1994–2005) dhe një parti të vogël të majtë, Partinë Socialiste të Punës së Kroacisë (SRP). Šušvar ishte i njohur si një ideolog marksist i përjetshëm dhe kundërshtar i nacionalizmit.

<sup>20</sup> Muhamet Pirraku, *Lëvizja gjithëpopullore shqiptare...*, 14; Aziz Abrashi - Burhan Kavaja, *Epopeja e minatorëve...*, 34-35; Azem Vllasi, *Kosova: Fillimi që nuk harrohet...*, 530-531.

Me kërkesat e minatorëve të Stantërgut u solidarizuan të gjithë shqiptarët e Kosovës, u solidarizuan fuqishëm minatorët e xehetarëve e minierave në Kishnicë, Hajvali, Novobërdë, Magurë, Golesh, Babush, Hade, Kastriot (Obiliq) e Siboc. Gjithashtu, me grevën e minatorëve u bashkuan edhe studentët e Universitetit të Prishtinës, të cilët hyrën në grevë në Palestrën Sportive në Prishtinë. Kërkesave që vinin nga zgafellet e minatorëve iu bashkëngjiten intelijenca, fshatarësia dhe qytetaria shqiptare e Kosovës dhe e viseve tjera etnike shqiptare.<sup>21</sup>

Përkrahje për grevistët e “Trepçës” pati edhe nga Sllovenia e Kroacia. Në Slloveni, krahas formave të ndryshme të përkrahjes, pati edhe tubime e protesta në mbështetje të grevistëve të minatorëve të Trepçës. Më 27 shkurt 1989, në Pallatin e Kulturës “Cankarjev Dom” në Lubjanë, ishte mbajtur një tubim i sllovenëve, në përkrahje të minatorëve grevistë në Stantërg. Në këtë tubim madhështor, kishin marrë pjesë përfaqësues të strukturave politike, shtetërore, sindikale, të shoqatave humanitare e të asociacioneve të tjera joqeveritare. Fjalën kryesore në këtë tubim e kishin mbajtur Milan Kuçani (shef reformator i Partisë Komuniste Sllovene) dhe Jozhe Smole (president i Sllovenisë), të cilët kishin deklaruar: “Ne sllovenët jemi një popull i vogël dhe mu për këtë solidariteti ynë me minatorët e rrezikuar është i afërt me ta, prandaj, me këtë rast pa fije dyshimi shqiptarët në konfliktin e tyre kanë të bëjnë me tendenca serbomadhe”.<sup>22</sup> Të gjithë të pranishmit në atë tubim, kishin shprehur shqetësimin e tyre për shëndetin dhe jetën e minatorëve të Kosovës, duke theksuar se jeta e tyre është gjëja më e çmueshme.<sup>23</sup> Po ashtu, brenda një kohe shumë të shkurtër, mbi 450 000 sllovenë nënshkruan një peticion në përkrahje për grevistëve.<sup>24</sup>

<sup>21</sup> Muhamet Pirraku, *Lëvizja gjithëpopullore shqiptare...*, 14.

<sup>22</sup> Eqrem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës më 1968, 1981 dhe 1989*, Prishtinë, 2011, 195.

<sup>23</sup> Aziz Abrashi - Burhan Kavaja, *Epopeja e minatorëve...*, 101-103.

<sup>24</sup> Oliver Jeans Schmit, *Kosova - Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë, 2012, 242.

Televizioni slloven shfaqte pamje dhe deklarata agresive të demonstruesve serbë në Beograd duke dhënë komentime dhe duke e krahasuar fatin e shqiptarëve në Serbi me fatin e hebrenjve nën pushtimin nazist gjerman.<sup>25</sup> Ndërkohë, në Kosovë, krahas përkrahjes së madhe që minatorët grevistë kishin te populli shqiptar, më 21 shkurt 1989, në ditën e dytë të grevës, në mbrojtje të autonomisë dhe pozitës së saj kushtetuese, u prezantua Apeli i 215 intelektualëve shqiptarë të Kosovës, i cili në fakt, ishte përkrahje e madhe e kërkesave të grevistë të minierës së “Trepçës” dhe e të gjithë atyre që u bashkuan me kërkesat e minatorëve. Iniciator dhe përpilues të “Apelit 215”, siç u njoh më vonë, ishin akademik Gazmend Zajmi dhe historiani Zekrija Cana.<sup>26</sup> Në këtë Apel të punonjësve shkencorë e kulturorë, ndër të tjera, i bëhej kritikë qasjes nacionaliste mesjetare serbe dhe politikës hegjemoniste ndaj Kosovës, vlerësohej Lufta Nacionalçlirimtare dhe Revolucioni Socialist. Në tekst thuhej se apeli ishte legjitim dhe kushtetues “i frymëzuar nga vlerat më të çmueshme të Revolucionit Socialist”, dhe kishte për qëllim “afirmimin e pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të Kushtetutës së RSFJ-së. Pas publikimit të “Apelit 215” në Kosovë u zhvillua një fushatë e egër e diferencimit ideopolitik duke i stigmatizuar organizatorët dhe nënshkruesit e këtij apeli.<sup>27</sup>

Derisa minatorët ishin në grevë, më 24 shkurt 1989, po nga këta u iniciua kërkesa që në Kosovë të fillojë falja gjithëkombëtare e gjaqeve. Sipas Abrashit e Kavajës, Halil Istrefi ishte ai i cili koordinoi këtë iniciativë të minatorëve, ndërsa Sejfedin Istrefi këtë kërkesë ia komunikoi opinionit përmes mjeteve të informimit. Iniciativa e minatorëve grevistë për pajtimin e gjaqeve filloi menjëherë. Gjersa minatorët grevistë po qëndronin heroikisht në zgafelle, shumë gjaqe

<sup>25</sup> Eqrem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës...*, 195.

<sup>26</sup> Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, *Fjalori Enciklopedik i Kosovës I (A - K)*, Prishtinë, 2018, 55.

<sup>27</sup> Po aty.

ishin falur.<sup>28</sup> Në bazë të konstatimit të dy drejtuesëve të Kombinatit Metalurgjik të Trepçës, Aziz Abrashit e Burhan Kavajës, në Kosovë në atë kohë ishin të mbyllura mbi 1 000 familje për arsye të rrezikut të hakmarrjes.

Në këtë situatë, grevistët i vizituan dhjetëra politikanë me ndikim të kohës duke përfshirë: Stipe Shuvarin (anëtar i Kryesisë së ish-Jugosllavisë, që përfaqësonte Kroacinë) dhe Remzi Kolgecin (kryetar i Kryesisë së Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës 1988-1990), të cilët vizituan minatorët më 24 shkurt 1989<sup>29</sup>. Stipe Shuvari, nuk kishte as kompetencë e as guxim, e me gjasë as vullnet që t’ju premtonte minatorëve asgjë lidhur me kërkesat e tyre. Ishte planifikuar që minatorët t’i vizitonte edhe diktatori Millosheviq, por, për arsye të shumë faktorëve, me theks të veçantë të asaj se shqiptarët nuk e dëshironin fare, ai nuk i vizitoi grevistët.<sup>30</sup>

Mirëpo, me rastin e vizitës së Shuvarit, një nga protagonistët kryesorë grevistë që kishte folur para tij, kishte qenë Mursel Haziri. Për shkak të fjalimit të tij interesant për kohën dhe rrethanat, po e paraqes një pjesë të asaj fjale: “Shoku kryetar, siç e dini, në flamurin e Lidhjes së Komunistëve shkruan: Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni, e jo: ndahuni në bazë të përkatësisë kombëtare. Nëse Lidhja e Komunistëve është avangardë e klasës punëtore, ajo duhet të dëgjojë klasën e vet, e jo t’ia kthej shpinën. Ne e kemi thirrur avangardën tonë që të na ndihmojë, por zëri ynë ka mbetur zë i humbur në shkretëtirë, madje që nga nëntori i vitit të kaluar. Pse, nuk e di. Rënia e një njeriu të vogël, shoku kryetar, është rënie e një njeriu të vogël, kurse rënia juaj do të ishte rënie e tërë vendit. Është fakt se ka ndarje në baza nacionale. Mirëpo, fara e kësaj ndarje është mbjellë nga vetë Komiteti Qendror, nga anëtarët e tij. Pak më parë më thatë se dorëheqjet janë punë e vullnetit të individit, kurse shkarkimet jo. E

<sup>28</sup> Muhamet Pirraku, *Lëvizja gjithëpopullore shqiptare...*, 16.

<sup>29</sup> Hilimi Saraçi, *Ibush Jonuzi dhe minatorët grevistë të Trepçës*, Prishtinë, 2019, 132.

<sup>30</sup> Azem Vllasi, *Kosova - fillimi që nuk harrohet...*, 532 - 534.

unë, edhe po të isha Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, pra, vetë Peres de Kuelari<sup>31</sup>, në rrethana të tilla do të jepja dorëheqje, pa vrarë mendjen shumë. Thatë shoku kryetar se shkarkimet nga tubimet janë akte antikushtetuese. E me sa e di unë nga gazetatat, deri tash në Jugosllavi janë shkarkuar rreth shtatë mijë funksionarë. Shoku kryetar, juve dhe mbarë Jugosllavinë, ndërgjegjen tuaj dhe të tjerëve, ju pyes çfarë do të bënit sikur këtu ta kishit babanë tuaj? Le të shohë atdheu ynë si silleni me ne. Por ju lutem, mos e turpëroni titullin që mbani. Shikoni masën këtu, gjysma e të cilëve po qan. Ndonjë nënë mund të mbesë pa djalë, ndonjë fëmijë pa prind, ndonjë grua pa bashkëshort ose pa vëlla. Si thoni ju, më të rëndësishëm janë kolltukët e tre vetëve, apo fati i këtyre njerëzve. Ali Shukriu, këtu në Shalë, gjatë luftës ka ngrënë, është mjekuar kur është plagosur. Por të gjitha këto i ka harruar, dhe ia ka kthyer shpinën Shalës. A s'është edhe ky në fakt?"<sup>32</sup> Shuvari kishte menduar se Mursel Haziri nuk mund të jetë minator, për arsye të artikulimit të qartë dhe shumë domethënës me rastin e fjalës që kishte mbajtur para tij, në prezencë të minatorëve grevistë<sup>33</sup>. Grevistët i kishte vizituar edhe Azem Vllasi, për të cilin, pushteti serb i kohës, besonte se mbrapa këtyre ngjarjeve ishte edhe vetë Vllasi.<sup>34</sup>

Pas tetë ditësh greve në zgafellen e Stantërgut, u "konfirmua" lajmi se kanë dhënë dorëheqje Ali Shukriu, Rrahman Morina dhe Hysamedin Azemi. Pas kësaj minatorët pranuan të dilnin nga nëntoka e "thellë" dhe të shohin diellin, me shpresë se tani e tutje Kosova do të ecë përpara ashtu siç kishin ecur republikat e tjera të ish-Federatës Jugosllave. Mirëpo, fatkeqësisht ndodhi e kundërta. Pushteti i pushtuesit serb, në krye me S. Millosheviqin, kishte tradhtuar

<sup>31</sup> Peres de Kuelari ishte diplomat, i cili lindi më 1920 në Lima (kryeqytet i Perusë) dhe vdiq më 2020, po në Lima. Në vitet 1982-1991 ka qenë Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuar, ndërsa, në vitet 2000-2001, ka qenë kryeministër i Perusë.

<sup>32</sup> Hilimi Saraçi, *Ibush Jonuzi dhe minatorët grevistë të Trepçës...*, 133-134.

<sup>33</sup> Po aty, 136.

<sup>34</sup> Azem Vllasi, *Populli që shkroi historinë - vitet e zgjimit...*, 197.

minatorët shqiptarë. Kështu, në krye të Kosovës ende qëndronin shqiptarët “e ndershëm”.

Mirëpo, sikurse në kohën e marshit të minatorëve, kur ishte mbajtur një tubim i madh në Beograd, edhe tani, të nesërmen e daljes së minatorëve, atje (Beograd) ishte organizuar një tubim i madh i serbëve me rreth një milion pjesëmarrës,<sup>35</sup> ku u kërkua arrestimi i “organizatorëve” të grevës së Stantërgut. Përpara qindra mijëra serbëve të tubuar në Beograd, foli edhe diktatori Millosheviq. Ai u premtoi protestuesve se do të burgosen “organizatorët” e grevës së Stantërgut dhe se së shpejti do t’i rikthehet “krenaria” shtetit serb.<sup>36</sup>

Në qarqet udhëheqëse serbe në Beograd, vlerësohej se, prapa këtyre ngjarjeve, sidomos të marshit dhe grevës së minatorëve, qëndronin Azem Vllasi dhe dhjetëra udhëheqës të institucioneve të ndryshme të Kosovës, me theks të minierës së Trepçës<sup>37</sup>. Prandaj, okupatori serb, nën pretekstin e organizimit të grevës si minatorëve, kishte burgosur: Azem Vllasin, Aziz Abrashin, Burhan Kavajën, Lazër Kransniqin, Ibush Jonuzin, Mensur Fejzën, Rizah Musliun, Ismail Nimanin, Mursel Hazirin, Sinan Kurteshin, Ramiz Kadriun, Veli Osmanin, Avdi Ukën, Jetish Bajramin dhe Tahir Sinanin.<sup>38</sup> Mirëpo, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, pas administrimit të procesit gjyqësor, më 24 prill 1990, kishte marr vendim lirues për të akuzuarit e lartshënuar.<sup>39</sup> Duhet thënë se, minatorët e Trepçës kishin mbajtur edhe disa greva tjera, ngase realisht ishin tradhtuar dhe nuk ishin zbatuar e përmbushur kërkesa e grevës së madhe të shkurtit 1989. Kështu u mbajtën greva në mars, në gusht dhe në tetor të 1989.<sup>40</sup> Megjithatë, marshi i nëntorit 1988 dhe greva e shkurtit 1989, nuk

<sup>35</sup> Oliver Jeans Schmit, *Kosova - Histori e shkurtër...*, 242.

<sup>36</sup> Eqrem Zenelaj, *Shtypi i Austrisë për demonstratat e shqiptarëve të Kosovës...*, 193-194.

<sup>37</sup> Muhamet Pirraku, *Lëvizja gjithëpopullore shqiptare...*, 16.

<sup>38</sup> Aziz Abrashi - Burhan Kavaja, *Epojeja e minatorëve...*, 140.

<sup>39</sup> Po aty.

<sup>40</sup> Po aty, 145-135.

arritën ta ndërrojnë kahen e rrjedhave antishqiptare që pushteti serb i udhëhequr nga Millosheviqi, po vendoste në Kosovë.

### **Gjendja në Kosovë pas përfundimit të marshit dhe grevës së minatorëve**

Pas marshit dhe grevës së minatorëve, në Kosovë u vendos gjendja e jashtëzakonshme dhe ora policore nën presionin e 30 mijë policëve të sjellë nga Serbia. Mirëpo, demonstratat kundër suspendimit të Autonomisë së Kosovës nuk u ndalën për asnjë çast. Megjithatë, më 23 mars 1989 nën gjendjen e jashtëzakonshme dhe nën kërcënimin e armëve, si dhe me anë të votave të disa jo parlamentarëve, Kuvendi i Kosovës aprovoi amendamentet për ndërrimin e Kushtetutës së vitit 1974. Edhe *de jure* u suprimua Autonomia e Kosovës. Gjatë demonstratave kundër suspendimit të Autonomisë ishin vrarë 37 shqiptarë. Ndërkaq, më 28 mars 1989, në Beograd Kuvendi Federativ i Jugosllavisë ratifikoi vendimet e Kuvendit të Kosovës, të 23 marsit 1998.<sup>41</sup>

Derisa në Beograd po festohej “fitorja” e Serbisë, në Kosovë forcat ushtarako-policore jugosllave vranë dhjetëra demonstrues shqiptarë që kishin dalë në mbrojtje të Autonomisë së Kosovës. Policia Speciale jugosllave, për të shpërndarë protestuesit, përdori gazin lotsjellës, rrahjet fizike, burgosjen e qindra shqiptarëve etj. Pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës dhe vendosjes së regjimit fashist millosheviqian, gradualisht udhëheqjen e Kosovës pothuajse tërësisht e mori në dorë pakica serbe. Ngjarjet e nëntorit 1988 dhe të shkurtit 1989 në Kosovë kishin “befasuar” edhe udhëheqjen serbe e jugosllave të asaj kohe. E një nga ta, ishte edhe Llazar Mojsovi<sup>42</sup>, i cili

<sup>41</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar IV*, Tiranë, 2008, 372.

<sup>42</sup> Llazar Mojsov u lind në vitin 1920 në Negotin (Maqedoni e Veriut). Ai luftoi bashkë me partizanët antifashistë në Luftën e Dytë Botërore dhe vazhdoi të ngrihej në radhët e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë pas vitit 1945. Ka qenë prokuror i përgjithshëm i Republikës Socialiste të Maqedonisë, si pjesë e ish-Jugosllavisë që ishte. Në kohën e ekzistencës së Jugosllavisë titiste (1944-1991) mbajti poste të

në ekranet televizive të TVB (Televizioni i Beogradit), TVP (Televizioni i Prishtinës), TVNS (Televizioni i Novi Sadit) etj., më 1 mars 1989, në emisionet e mbrëmjes, përveç tjerash kishte deklaruar: *Se ekzistojnë tri faza të veprimtarisë kundërrevolucionare të separatistëve shqiptarë, nga të cilat e para është greva e përgjithshme, e realizuar me manipulime të shkathëta me jetën e 1 300 minatorëve të Stantërgut, të cilët kishin afër vetes 2.5 tonë dinamit. Faza e dytë ishte aksioni me rastin e debatit për amendamentet kushtetuese të RS-së së Serbisë, dhe faza e tretë, kryengritja e armatosur.*<sup>43</sup>

Duhet thënë se dallimi në mes të protestave apo marshit dhe të grevës së minatorëve ishte, se:

- marshi protestues përkrahte udhëheqjen e Kosovës që mos të dorëzohet dhe mos të jap dorëheqje nga presioni serb, ndërsa;
- greva ishte në mbrojtje të Kushtetutës së Kosovës, e cila ishte në prag të ndryshimit e të rrënimit të saj me dhunë nga Serbia.

Marshi dhe greva e minatorëve kishte shokuar edhe Millosheviqin, për arsye se top lajm në atë kohë jo vetëm në ish-Jugosllavi, por edhe në media të tjera ndërkombëtare, ishin bërë këto ngjarje. Andaj, ai nuk mund ta përballonte dot, se vëmendja tash, nuk ishte vetëm te Millosheviqi, por edhe për gjendjen në Kosovë dhe se për të kjo ishte e papranueshme, sepse, përveç tjerash vuante nga kompleksi që çdo herë në top lajme të ishte vetëm ai. Prandaj, efektet politike të këtyre dy ngjarjeve në ish-Jugosllavi, e sidomos efekti i grevës, ka qenë i madh.

---

ndryshme politike, si: deputet, ambasador në Bashkimin Sovjetik, Mongoli, Austri, në Kombet e Bashkuara. Gjatë viteve 1974-1982 Mojsovi ishte zëvendësministër i Jashtëm i Jugosllavisë dhe në vitet 1977-1978 ishte president i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Edhe në vitet e '80-ta të shekullit të kaluar, kishte mbajtur poste të rëndësishme politike në ish-RSFJ. Llazar Mojsovi ka vdekur në vitin 2011 në Beograd, ku edhe u varros. Ka qenë i njohur sidomos për deklaratat e tij antishqiptare.

<sup>43</sup> Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999)*..., 258.

Si rrjedhojë e efektit politik që patën marshi dhe greva e minatorëve në ish-Jugosllavi, pastaj indinjimit të madh të shqiptarëve me suprimim e Autonomisë së vitit 1974, gjatë viteve të '90-ta të shekullit të kaluar në Kosovë ndodhën ngjarje të shumta. Një nga ngjarjet ku Millosheviqi edhe hapur i shprehu pretendimet e tij për krijimin e Serbisë së Madhe, ishte organizimi i manifestimit të madh në Kosovës, më 28 qershor 1989, me rastin e 600-vjetorit të Betejës së Kosovës, për të cilën historiografia serbe ka bërë falsifikime të mëdha për këtë ngjarje, duke u munduar ta paraqes se aty, më 28 qershor 1389, serbët kinse paskan mbrojtur Kosovën dhe Evropën nga pushtimet osmane (turke-aziatike)!

Në tubimin e madh në Gazimestan (fshat në veri të Prishtinës), morën pjesë rreth një milion serbë të ardhur nga vise të ndryshme dhe të organizuar mirë, duke ua siguruar edhe transportin falas. Aty, krahas të tjerëve, fjalën kryesore e ka pasur Millosheviqi, i cili përveç tjerash, kishte thënë: “Sot, gjashtë shekuj më vonë, ne sërish po luftojmë dhe po shohim luftëra. Këto nuk janë luftëra të armatosura, ndonëse edhe diçka e tillë nuk mund të përjashtohet”.<sup>44</sup> Në mars të viti 1990 ndodhi helmimi i nxënësve. Më 31 mars 1990, në mënyrë mizore, me mbi 500 policë serbë u rrethua e u maltretua tmerrësisht Nuredin Gubetini dhe familja e tij në fshatin Nadakoc të Vushtrrisë.<sup>45</sup>

Në rrethana të tilla, u mor iniciativa për të anuluar vendimin e kontrabanduar të Kuvendit të Kosovës, të datës 23 mars 1989, që kishte suprimuar Autonominë si dhe u vendos që Kosova të shpallej njësi e barabartë, që nënkuptonte republikë në kuadër të Federatës apo Konfederatës Jugosllave. Në grupin nismëtar për të shpallur Kosovën njësi të barabartë, përveç tjerash, bënin pjesë: Bujar Gjurgjalla, Muharrem Shabani, Ramadan Kelmendi, Ruzhdi Bakalli, Shaban Hasani, prof. Skënder Skënderi etj. Ky grup, i cili u përkrah edhe nga delegatët e tjerë, jo vetëm që kundërshtonte zbatimin e ndërrimeve kushtetuese, por filloi iniciativën për shpalljen e Kosovës si njësi e

<sup>44</sup> Oliver Jeans Schmit, *Kosova - Histori e shkurtër...*, 244.

<sup>45</sup> Izet S. Miftari, *Viciana - Vushtrria I...*, 270 -273.

barabartë me ish-republikat e Federatës Jugosllave.

Për këtë qëllim, ishte formuar edhe Komisioni i veçantë për të punuar në këtë drejtim. Kuvendi i Kosovës në atë kohë filloi ta denoncojë hapur dhunën dhe vrasjet që ushtria dhe policia serbe i ushtronte mbi shqiptarët e Kosovës. Kështu, më 30 janar 1990 në Satnoc të Vushtrrisë ushtria dhe policia serbe kishte vrarë dy shqiptarë të këtij fshati dhe kishte plagosur dhjetëra të tjerë. Dy të vrarët në Stanoc ishin: Sadik Malaj (23 vjeç) dhe Sadri Maksuti (58 vjeç).<sup>46</sup> Në vitin 2009, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë ka ndarë mirënjohje për dy të rënë në Stanoc.<sup>47</sup> Edhe pse organet serbo-jugosllave në çdo mënyrë u munduan që të pengojnë shpalljen e Kosovës si njësi të barabartë në kuadër të Federatës apo Konfederatës Jugosllave<sup>48</sup>, delegatët shqiptarë më në fund vendosën që në mbledhjen e 2 korrikut 1990 ta shpallin këtë. Kështu, në mbledhjen e 1 korrikut 1990, rreth 20 delegatë shqiptarë kishin mbajtur një mbledhje të fshehtë në shtëpinë e prof. Skënder Skenderit në Prishtinë. Aty ishte debatuar dhe hartuar Deklarata dhe ishte vendosur që atë ta lexojë Muharrem Shabani,

---

<sup>46</sup> Ferit Dibrani, *Rrëfime për krimet serbe dhe qëndresa shqiptare*, Vushtrri, 2014, 210; Abdullah A. Bytyçi, *Terrori shtetëror dhe gjenocidi serbo-malazez në Kosovë 1878-1991*, Prishtinë, 2001, 138.

<sup>47</sup> Kuvendi Komunal në Vushtrri - Zyra e Sekretarisë së kryetarit.

<sup>48</sup> Në këtë kohë, diskutohej jo pak që ish-Jugosllavia të mund të ristrukturohej në një rregullim tjetër shtetëror, dhe të kalohej nga rregullimi federativ, që kishte qenë sipas Kushtetutës së vitit 1974, në atë konfederativ dhe që të mund të merrje si model ndonjë shtet që kishte një sistem të tillë shtetëror, siç është p.sh. Zvicra, që pak a shumë ka një modalitet të tillë shtetëror. Por, kjo nuk u arrit, ngase Millosheviqi synonte të centralizonte pushtetin jugosllav dhe ta vendoste në krye të saj hegjemoninë serbe. Andaj, si pasojë e kësaj, filluan luftërat tragjike në këtë shtet dhe që pastaj u shpërbë. Në rrethana të tilla, shqiptarët u organizuan në forma të ndryshme për të mos pranuar që të jenë pjesë e Serbisë, duke formuar Lidhjen Demokratike të Kosovës në fund të vitit 1989, pastaj krijuan institucionet paralele, derisa në vitin 1998, Ushtria Çlirimtare e Kosovës filloi luftën e hapur e që kulmoi me intervenimin e NATO-s, më 24 mars 1999 dhe me dorëzimin e forcave serbe sipas Marrëveshjes së Kumanovës (9 qershor 1999), që parashihte largimin e të gjithë trupave ushtarakë, policorë e paramilitarë (serbë) nga Kosova.

delegat i Vushtrrisë.<sup>49</sup> Të nesërmen, më 2 korrik 1990, delegatët shqiptarë iu kishin mësyre ndërtesës së Kuvendit. Mirëpo, forca të mëdha ushtarake dhe policore serbe kishin ndaluar hyrjen e delegatëve në sallën e Kuvendit. Në këtë situatë, delegatët shqiptarë kishin vendosur që Deklaratën e Shpalljes së Kosovës si njësi e barabartë në kuadër të Federatës apo të Konfederatës Jugosllave ta bëjnë përpara ndërtesës së mbyllur të Kuvendit.<sup>50</sup>

Mirëpo, situata ishte shumë e rëndë, ngase Millosheviqi nuk e kishte njohur vullnetin politik të shqiptarëve të shprehur përmes delegatëve të tyre në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës më 2 korrik 1990. Prandaj, tri ditë më vonë, Kuvendi i Serbisë, i mbajtur më 5 korrik 1990, mori vendim që të ndërpresë punën dhe të shpërndajë Kuvendin e Kosovës dhe Këshillin Ekzekutiv të Kosovës (Qeveria) dhe të shumë institucioneve tjera. Me këtë vendim, praktikisht kishte filluar të vendosen masat e dhunshme thuajse në të gjitha institucionet e Kosovës, duke përfshirë edhe në mediumin e vetëm të shqiptarëve, në Televizionin e Prishtinës (TVP), në gazetën e vetme të përditshme “Rilindja”, në revistën “Zëri i rinisë“ etj.<sup>51</sup>

Marshi dhe greva e minatorëve e viteve 1988-1989, ishte një nga shkëndijat e para të fillimit të fundit të ish-Jugosllavisë titiste dhe rënies së sistemit komunist në Evropën Lindore. Për shkak të gjendjes së rëndë të shqiptarëve në Kosovë, veçanërisht pas Demonstratave të vitit 1981, me ç’rast filloi një propagandë shumë e rëndë dhe e sofistikuar antishqiptare, gjithsesi se edhe populli shqiptar në Kosovë e kishte të imponuar reagimin dhe kundërshtimin me situatën e krijuar. Kulmi i propagandës së rëndë arriti pas ardhjes në krye të Serbisë të diktatorit Slobodan Millosheviq (1986). Prandaj, në rrethana të tilla, të elektrizuara e të tensionuara, ndër të parët që reagueshan me gjendjen e krijuar, e sidomos për të mos pranuar ndërrimet kushtetuese të Kushtetutës së vitit 1974, ishin minatorët e Trepçës, të

<sup>49</sup> Kuvendi i Vushtrrisë, *Vushtrria - Vicianë me rrethinë*, Vushtrri, 2003, 219.

<sup>50</sup> Noel Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër...*, 433.

<sup>51</sup> Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912 - 1999)...*, 280.

cilët kishin ardhur në përfundim se shumë çështje me rëndësi kombëtare do të mbesin pa u zgjidhur drejt dhe se do të imponoheshin zgjidhje që rëndonin pozitën e shqiptarëve të Kosovës, nëse nuk do të ketë kundërshtime të fuqishme. Andaj, nga 17 deri më 21 nëntor 1988, u organizuan marshe protestuese në tërë Kosovën, me qëllim që të kundërshtohet çdo përpjekje për të cenuar disa të drejta themelore që kishin shqiptarët sipas Kushtetutës së vitit 1974. Organizatorët kryesorë të këtij marshi ishin minatorët e Trepçës.

Meqenëse marshi protestues nuk u pa që po jepte rezultate në parandalimin abrogimit të Kushtetutës së '74-ës, minatorët e Stantërgut filluan me veprim edhe më të ashpra kundër regjimit të Millosheviqit, duke hyrë në grevë të përgjithshme urie. Kjo grevë filloi më 20 dhe mbaroi më 28 shkurt 1989. Greva pati jehonë të madhe jo vetëm te populli shqiptar, por edhe në tërë ish-Jugosllavinë dhe në arenën ndërkombëtare. Një nga 10 kërkesat e minatorëve grevistë ishte edhe: “Ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës dhe shqyrtimi i statusit të Kosovës në Kombet e Bashkuara”. Pra, që nga kjo kohë, Kosova në të vërtetë filloi të ndërkombëtarizohet dhe gradualisht nga Fuqitë e Mëdha e veçanërisht nga SHBA-ja u nënkuptua se duhet të zgjidhet. Si përfundim, konstatoj se, efektet politike të këtyre dy ngjarjeve në ish-Jugosllavi e sidomos efekti i grevës ka qenë i madh. Çka më së shumti bie në sy është se në të dy këto lëvizje të mëdha nuk ishte dëgjuar asnjë parullë me përmbajtje raciste apo kundër popullit serb. Në të kundërtën, në mitingjet serbe ishin dëgjuar e shkruar parulla me përmbajtje raciste e antishqiptare.